

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Nesrin Lushta, kryetare, Emine Mustafa dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Bujar Balaj procesmbajtës, në çështjen penale kundër dënuarit A.B., nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPK, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1292/2017 datë 9.2.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7 maj 2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit A.B., paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PA1.nr.1292/2017 datë 9.2.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës themelore Gjilan P.nr.1054/2017 datë 9.11.2017, i dënuari A.B., është shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par. 9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPK dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditësh i cili dënim në pajtim me dispozitën e nenit 47 të KPK i është zëvendësuar me dënim me të holla në shumë prej 3.200 €, të cilin dënim është i obliguar që të paguaj në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit. Në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 24.3.2017 gjerë më 12.4.2017. Është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit të kategorisë "B" në afat prej 3 vitesh. Është detyruar që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30€ si dhe shpenzimet e procedurës penale dhe atë: për ekspertizë të komunikacionit shumë prej 122.64 €, në afat prej 15 ditësh pas

plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.1292/2017 datë 9.2.2018 me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Shteti, e ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që të dënuarin A.B., për të njëjtën vepër penale e ka gjykuar më dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 24.3.2017 gjerë më 12.4.2017. Në pjesën tjetër aktgjykimi ka ngelur i pandryshuar

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit A.B., M.M., avokat nga Gj., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që të ndryshohet dhe të dënuarit t'i shqiptohet një dënim dukshëm më i butë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës me parashtresën KMLP.II.nr.58/2018 datë 29.3.2018, ka dhënë përgjigje në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë duke propozuar që të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes, vlerësoi pretendimet e mbrojtësit të paraqitura në kërkesë në pajtim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Nga shkresat e çështjes rezulton se i dënuari A.B., është shpallur fajtor për veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.9 lidhur me par.6 dhe 1 të KPK. Aktgjykimi i shkallës së parë është marr mbi bazën e pranimit të fajësisë, meqë i dënuari në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 7.4.2017, në praninë e mbrojtësit, av. M.M. ka pranuar fajësinë, për të gjitha pikat e aktakuzës. Siç u theksua më lartë, dënimi i shqiptuar nga kjo gjykatë, është ndryshuar me aktgjykimin e shkallës së dytë.

Nuk është i bazuar pretendimi se aktgjykimi i kundërshtuar është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.8 të KPPK gjegjësisht se gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye për faktet relevante përkitazi me vendimin për dënimin. Kjo nga fakti se siç rezulton nga aktgjykimi i kundërshtuar, gjykata e shkallës së dytë, ka dhënë arsye ligjore lidhur me dënimin e shqiptuar madje edhe për ashpërsimin e dënimit, siç ka paraqitur në faqen 3 të aktgjykimit, të cilin konkludim si të drejtë e pranon edhe kjo gjykatë.

Pjesa tjetër e kërkesës ka të bëjë me shkeljen e ligjit penal në dëm të dënuarit, e cila shkelje sipas thënieve nga kërkesa, konsiston në atë se nuk janë vlerësuar drejtë

rrethanat për matjen e dënimit, në veçanti pranimi i fajësisë dhe rrethana tjera lehtësuese, kështu që gjykata e shkallës së dytë është dashur që të aplikoj nenin 76 të KPK dhe të dënuarit t'ia zbusë dënimin, meçe dënimi i shqiptuar është shumë i ashpër.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstaton se konform dispozitës së nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënimin, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënimin, dënimin alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm, për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore. Në rastin konkret gjykata e shkallës së dytë, ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale, për çfarë ka dhënë arsye të qarta dhe ligjore të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë.

Në rast se nuk është fjala për këtë shkelje, vendimi për dënimin me këtë mjet të jashtëzakonshëm juridik, mund të kundërshtohet vetëm nëse kjo pjesë e aktgjykimit është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e cila do të mund të ndërlihej me mungesën ose paqartësitë e arsyeve lidhur me vendimin për dënimin, mirëpo, në rastin konkret për këtë pretendim janë dhënë arsye më sipër në këtë aktgjykim.

Nga arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 347 të KPPK është vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË
Pml.nr.80/2018, më 7 maj 2018

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta